



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të
Nr. 18/08
Prishtinë, më 24.07.2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Safete Hadërgjonaj, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Müfera Şinik, Shkumbin Demaliaj.

Anëtarët jo të pranishëm: Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Xhevdet Neziraj, Hajdin Abazi dhe Behxhet Pacolli.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Arta Hajra, Vilson Ukaj.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Ahmet Shala, zv.ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Bedri Hamza, Drejtor i Buxhetit pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave z. Agim Krasniqi, Halit Muharremi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Niman Zeneli, Fatmir Uka, Qerkin Morina nga Zyre e Auditorit të Jashtëm, Mentor Osmani nga Kuvendi i Kosovës, monitruues nga OSCE, NDI, KDI, Z.P.R.K.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e 11 korrikut 2008.**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-088 mbi miratimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimeve të autorizuara për periudhën 1 janar deri më 21 dhjetor 2008, me kërkesat e buxhetore nga :**

- Zyra e Auditorit Gjeneral
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave
- Sekretari i Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Të ftuar: Përfaqësuesit e institucioneve parashtruese të kërkesave buxhetore.

4. Të ndryshme.

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e 11 korrikut 2008.

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhjet e dt. 11 korrik 2008, u miratuan pa vërejtje.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-088 mbi miratimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimeve të autorizuar për periudhën 1 janar deri më 21 dhjetor 2008, me kërkesat e buxhetore nga :

- Zyra e Auditorit Gjeneral
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave
- Sekretari i Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Të ftuar: Përfaqësuesit e institucioneve parashtruese të kërkesave buxhetore

Kryesuesi, theksoi se rishikimi i buxhetit në të kaluarën nuk është shqyrtuar nga Komisioni dhe Kuvendi, ndërsa pas miratimit të Ligjit të ri të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësi, MEF-i obligohet që buxhetin e përgjithshëm në periudhën gjashtë mujore ta dërgojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Konform Ligjit të lartpërmendur, MEF-i buxhetin e rishikuar e ka proceduar me kohë në Kuvend.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Ahmet Shala, njoftoi anëtarët e Komisionit se me gjithë angazhimet që ka pasur MEF-i në, përgatitjen për Konferencën e donatorëve, i'u kemi përmbajtur afatit ligjor që rishikim i buxhetit në Kuvend të bëhet në muajin korrik. Gjatë rishikimit të buxhetit, kemi pasur parasysh prioritetet e Qeverisë dhe Agjensioneve Buxhetore. Ndryshimet që janë bërë janë të menduar mirë si të realizueshme. Në këtë kontekst kemi pasur parasysh komentet dhe vërejtjet e FMN-në, ndaj të cilave kemi argumentet tona.

Kryesuesi, duke komentuar buxhetin e rishikuar tha se pas leximit të tij ka vërejtur disa dallime në shifra, me ato fillestare të miratimit të buxhetit. Andaj kërkoi edhe sqarime për këto ndryshime nga përfaqësuesit e ministrisë. Duke u ndërlidhur me pjesën tabelore, tha se në pjesën të hyrat dhe shpenzimet vërejmë ndryshime të konsiderueshme. Pyeti se këto ndryshime a janë si rezultat i projekcionit të menduar mirë dhe të argumentuar apo ndryshimet janë të determinuar nga rrethanat tjera të krijuar, që kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve tjera, në krahasim me ato të planifikuar në fillim të vitit.

Zv.ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Bedri Hamza, duke komentuar rishikimin buxhetit, theksoi se kemi rritje si në pjesën e të hyrave po ashtu edhe në pjesën e shpenzimeve. Të hyrat janë më të mëdha

se sa janë planifikuar. Kjo fal të hyrave nga kufijtë e jashtëm. Ndërsa lidhur me rritjen e shpenzimeve, z. Hamza tha se kjo ka ndodhur si rezultat i shpenzimeve shtesë të krijuara nga disa Ministri. Janë disa Ministri të cilat kanë kërkuar mjete shtesë për t'i përballuar shpenzimet që do t'i kenë në pjesën e mbetur të vitit fiskal. Kërkesa të këtilla kanë bërë Ministria e Jashtme, Ministria e Arsimit (për të mbuluar pagat e arsimtarëve të rinj), Ministria e Pushtetit Lokal për implementimin e Ligjit mbi Qeverisjen Lokale (me të cilin është bërë ndërrimi i strukturës organizative të vetëqeverisjes lokale), Ministria e Shëndetësisë (për të siguruar fondi shtesë për blerjen e barnave esenciale), pastaj një pjesë e mjeteve shtesë për Ministrinë e Drejtësisë (çmimet për disa kategori janë paraparë në bazë të çmimit të vitit 2007, ndërsa të njëjtat çmime janë ngritur në vitin 2008). Sa i përket kategorive të shpenzimeve kemi një ngritje të lehtë në mallra dhe shërbime. Subvencionet dhe transferet janë rritur në pjesën që i është destinuar për KEK-un. Ndërsa është ruajtur raporti në mes shpenzimeve kapitale dhe operative. Nëse i krahasojmë shpenzimet kapitale që janë bërë këto gjashtë muaj në krahasim me periudhën paraprake, kemi një rritje më përmasa shumë më të mëdha në realizimin e tyre.

Armend Zemaj, lidhur me ndryshimet në kategorinë e shpenzimeve kapitale, pyeti përfaqësuesit e ministrisë, se sa ofroni siguri se këto projekte të rialokuar do të përfundohen brenda vitit 2008. Kërkojë që për të gjitha pozicionet buxhetore të vepohet me racionalitet me rastin e shpenzimit të mjeteve buxhetore.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Ahmet Shala, lidhur me pyetjen e z. Zemaj, theksoi se nuk mund të garantojmë se do të bëhet ekzekutimi i 100% i projekteve kapitale, por nga të dhënat që disponojmë, shihet se Agjensionet Buxhetore ka përmisuar aftësinë planifikuese dhe ekzekutuese. Kjo ngjall shpresën se shumica e projekteve do të mund të përfundonin brenda vitit. Në kuadër të ndryshimeve kapitale, kemi pasur raste që disa organizata buxhetore janë deklaruar vullnetarisht se nuk munden të i ekzekutojnë projektet kapitale dhe ato mjete i'u janë dedikuar ndonjë organizate që ka shprehur gatishmëri në kryerjen e projekteve të saja kapitale. Në këtë mënyrë është bërë rialokimi i brendshëm i mjeteve. Po që se bëhet ekzekutimi i këtyre shpenzimeve kapitale, do të përfitonte shumë ekonomia e vendit dhe buxheti në këtë kategori do të realizonte qëllimin e vet.

Myrvete Pantina, lidhur me ndryshimet në buxhet, shfaq shpresën që ato që janë planifikuar të realizohen, sidomos shpenzimet kapitale. Sipas znj. Pantina shqetësim për të është pjesëmarrja e lartë e subvencioneve (28%) në kategorinë e shpenzimeve. Në veçanti kritikoi subvencionimin e KEK-ut dhe dhënien e kredisë prej 79 milion eurove. Shfaq shqetësimin se kjo mund të ndikojë negativisht në politikën menaxhues të KEK-ut. Pyeti se a kanë bërë krahasime me vitet e mëhershme për subvencionet e dhëna KEK-ut dhe çfarë ndikimi kanë pasur ato. Lidhur me këtë çështje znj. Pantina kërkoi që përveç përkrahjes së KEK-ut, të monitorohet dhe ndikohet menaxhimi i mjeteve publike që përfiton kjo organizatë.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Ahmet Shala, duke i'u përgjigjur pyetjeve të deputetes Pantina, theksoi se problemi i KEK-ut është krijuar në të kaluarën dhe po vazhdon edhe sot. Arsyet e dhënies së subvencionit (25 milion euro) kanë qenë sigurimi importit për këtë dimër. Ndërsa dhënia e kredisë, ka për qëllim renovimin e bllokut A5, që do të ndikonte rritjen e prodhimit dhe në zvogëlimin e importit. Në këtë drejtim MEF-i do të jetë strikt në menaxhimin e shfrytëzimit të këtyre mjeteve. Gjatë vitit 2009 do të kërkojmë që KEK-u të rris inkasimin dhe kjo do të ndikonte në zvogëlimin e madh të subvencioneve.

Kryesuesi, lidhur me Agjensionin e ashtuquajtur "Bordi i Pavarur Mbikëqyrës", që do të veprojë brenda strukturës së Kuvendit, theksoi se shihet një rritje të buxhetit të tij në të gjitha kategoritë për dallim prej vitit kaluar. Kërkoj arsyetim për këtë ndryshim.

Drejtor i Buxhetit pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave z. Agim Krasniqi, në përgjigjen e kryesuesit theksoi se Bordi i Pavarur Mbikëqyrës, ka funksionuar në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Ndërsa pas ndryshimeve të shkurtit, ky do të jetë organ i pavarur që të veprojë në kuadër të Kuvendit. Arsyeja e ngritjes së buxhetit të këtij agjensioni ka qenë ajo se pas pavarësimit janë krijuar disa pozita të domosdoshme, për t'i kryer punët që në të kaluarën i ka kryer Ministria përkatëse.

Shkumbin Demaliaj, duke ditur rëndësinë që ka buxheti për të gjithë qytetarët e vendit, kërkoi që për këtë dokument mos të ndahen në pozitë dhe opozitë, por të si Komision të dalin me një qëndrim të përbashkët. Duke analizuar buxhetin theksoi se i mungon një modifikim atij. Lidhur me rritjen e mjeteve për Ministrinë e Telekomunikacionit dhe Ministrinë e Shëndetësisë, pyeti se a është ndërruar destinimin i mjeteve të tyre. Po ashtu pyeti për mjetet për blerjen e barnave esenciale, a janë mjete shtesë apo të alokuara nga viti kaluar. Z. Demaliaj bëri vërejtje për rritjen e numrit të punëtorëve në institucionet publike, gjë që bie ndesh edhe me vendimin e ish-Qeverisë për zvogëlim të numrit të të njëjtëve. Lidhur me ndarjen e granteve për komunat shihet se ka ndryshime, pyeti pse ekziston një dallim i tillë, a është bërë kjo duke marrë për bazë diferencimet të komunave në të cilat qeverisë pozita dhe opozita apo është marrë parasysh kryerja e obligimit që kanë ato për të përfituar grantet.

Zv.ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Bedri Hamza, lidhur me rritjen e buxhetit, tha se janë shtuar vetëm 27 milion euro, pjesa tjetër është si rezultat i rialokimeve të brendshme të organizatave buxhetore. Është bërë bartja e mjeteve prej investimeve kapitale të një organizate buxhetore në një tjetër. Ndërsa në përgjigjen e z. Demaliaj, tha se nuk ka rritje të punëtorëve, përkundrazi zvogëlim në krahasim me vitin paraprak. E rëndësishme është se është ruajtur struktura aktuale, nuk ka pasur largim nga puna. Ndërsa sa përket ndarjes së granteve, kjo është bërë varësisht nga kryerja e obligimit që kanë komunat për të përfituar grantin stimulues (inkasimi i tatimit në pronë), e që deri më tani, në mënyrë të kënaqshme e kanë kryer vetëm tri komuna.

Haki Shatri, përgëzoi MEF-in, që përkundër angazhimeve që ka pasur, ka përgatitur buxhetin për rishikim brenda afatit të paraparë. Megjithatë bëri disa vërejtje në vazhdim. Sipas z. Shatri ekziston një mospërputhje në mes të të hyrave dhe shpenzimeve, një disproportcion në shifra të mëdha. Pavarësisht krijimit të Ministrive të reja dhe rritjes së numrit të punëtorët të arsimit, shifet se është rritur numri i punëtorëve në nivelin qendror. Sipas z. Shatrit janë rritur shumatat në të gjitha kategoritë. Prioritetet nuk janë konkretizuar. Disa sektorë janë favorizuar, si energjetika, e disa janë lënë anash, siç është sektori i sundimit të rendit dhe ligjit. Ndërsa rritja e mjeteve në Ministrinë me Shëndetësisë nuk favorizon daljen nga problemet. Ndryshimet në sektorin e transportit nuk shkojnë në ngritjen e kapaciteteve ekonomike, për arsye se janë lënë anash rrugët e mëdha strategjike, siq është rasti i Autostradës me Shqipërinë dhe mjetet e parapara për këtë projekt (49 euro) janë rialokuar për rrugë minore. Vërejtje bëri edhe për mjetet shtesë për sektorin e energjisë, që janë mjete konsumuese (rasti i mjeteve të ndara për import). Lidhur me këtë sugjeroi se Qeveria ka qenë dashur të hartoj një politikë më të qartë që do të ndikonte në ngritjen e inkasimit të KEK-ut. Lidhur me shumën e ndarë prej 3 mili. Eurove, të parapara si mjete për promovim, pyeti çfarë destinimin kanë ato. Pas këtyre vërejtjeve, tha se krijohet nevoja e amendamentimit të disa pikave të tij, përndryshe pas konsultimeve që ka pasur me grupin parlamentar, do ta përkrahim miratimin e tij.

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi të rëndësishme mundësin që ka Komisioni në qasjen së rishikimit të buxhetit, gjë që në të kaluarën nuk ka ndodhur. Lidhur me përgatitjen e buxhetit dhe ndryshimeve që janë bërë, megjithë nevojën për të bërë përmisime të vogla shihet se është një dokument më i mirë në krahasim me buxhetet e kaluara. Në veçanti znj. Hadërgjonaj vlerëson lëvizjet që janë bërë në projektet kapitale, të cilat ndikojnë direkt në zhvillimin ekonomik të vendit. Lidhur me ndarjen e mjeteve për rrugët minore, theksoi se nuk duhet lënë anash sepse investimi në to ndikon në përmisimin e jetës së qytetarëve, (asfaltimi i rrugëve mundëson realizimin shërbimeve tjera nga qytetarët). Problemi i KEK-ut, është një problem i trashëguar, por shfaq shpresën se që nga viti 2009, do të kërkohet llogari më e

madhe prej kësaj ndërmarrje publike. Kërkoj nga përfaqësuesit e ministrisë që anëtarëve të Komisionit t'iu sigurohet dokumenti i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Përndryshe theksoi se përkrah buxhetin e rishikuar dhe kërkoj anëtarët të përkrahin atë dhe të kalohet për miratim në Kuvend.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Ahmet Shala, u pajtua me disa nga vërejtjet e z. Shatri dhe znj. Hadërgjonaj, të cilat vërejtje kanë qenë edhe të MEF-it drejtuar Organizatave Buxhetore, e të cilat janë në të mirën e zhvillimit ekonomik të vendit. Sa i përket sigurimit të dokumentit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, është përgatitur versioni në gj. Angleze dhe së shpejti do të përgatite edhe në gj. shqipe dhe do ta kenë gjithë anëtarët. Arsyeja e rialokimi të brendshëm të shpenzimeve kapitale, ka qenë që të mundësohet shfrytëzimi i këtyre mjeteve nga ato organizata që kanë kapacitete dhe programe, e jo që ato t'i bartim vitin e ardhshëm, për shkak mosgatishmërisë së disa organizatave tjera për realizimin e tyre.

Zv.ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Bedri Hamza, në përgjigjen e pyetjeve të deputetëve, tha rritjet kanë ndodhur si rezultat i kërkesave shtesë të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Kulturës. Duke u ndërlidhur me pyetjen e z. Shatri, theksoi mbështetja e kërkesave të Ministrive të lartpërmendura (Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme), tregon se ne kemi përkrahur dhe ndihmuar rendin dhe ligjin. Sa i përket fondit të Autostradës, kanë mbetur 7 mil. Euro për t'u bërë shpronësimet.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shtatë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në cilësinë e komisionit funksional dhe raportues e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon që të njëjtin ta miratoj me amendamentet e propozuara.

Amendamentet e propozuara:

I. Amendamentet në pjesën tekstuale të Projektligjit

Amendamenti 1

Neni 2 riformulohet si vijon:

'Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.'

II. Amendamentet në pjesën tabelare të Projektligjit

Amendamenti 2

Në tabelën 2 **Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2008, A: Organizatat buxhetore që janë IPVQ, Rishikimi Gjashtëmujor**, në kodin organizativ 101 'Kuvendi', :

- në kodin e programit 101 'anëtarët e Kuvendit' nga kategoria **Paga dhe mëditje** hiqet shuma prej 99,000 €(nëntëdhjetë e nëntë mijë euro) dhe barten në kategorinë **Mallra dhe Shërbime**.

- në kodin e programit 102 'Personeli/administrata e Kuvendit', nga kategoria **Paga dhe mëditje** hiqet shuma prej 65,000 €(gjashtëdhjetë e pesë mijë euro) dhe barten ne kategorinë **Mallra dhe shërbime**.

Amendamenti 3

Në tabelën 2 **Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2008, A: Organizatat buxhetore që janë IPVQ, Rishikimi Gjashtëmujor**, në kodin organizativ 201 'Ministria për Ekonomi dhe Financa', kod i programit 220 'Energjia- KEK-u' nga kategoria '**Subvencione dhe Transfere**' hiqet shuma prej 2,000,000 €(dy milion euro), nga shuma totale prej 25,000,000 €(njëzet e pesë milion euro).

Amendamenti 4

Në tabelën 2 **Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2008, A: Organizatat buxhetore që janë IPVQ, Rishikimi Gjashtëmujor**, në kodin organizativ 201 'Ministria për Ekonomi dhe Financa', kod i programit 220 'Energjia- KEK-u' nga kategoria '**Shpenzimet kapitale**' hiqet shuma prej 9,000,000 € (nëntë milion euro), nga shuma totale prej 41,482,669 €(dyzet e një milion, e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë, e gjashtë qind e gjashtëdhjetë e nëntë euro).

Amendamenti 5

Në tabelën 2 **Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2008, A: Organizatat buxhetore që janë IPVQ, Rishikimi Gjashtëmujor**, në kodin organizativ 202 'Ministria e Shërbimeve Publike', kod i programit 128 'Regjistrimi i popullsisë', :

- nga kategoria '**Mallra dhe shërbime**' hiqet shuma prej 670,000 €(gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë euro) nga shuma totale prej 974,336 € (nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë euro, e treqind e tridhjetë e gjashtë euro)

- nga kategoria '**Shpenzimet kapitale**' hiqet shuma prej 330,000 €(treqind e tridhjetë mijë euro) nga shuma totale prej 1,017,080 €.(një milion, shtatëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë euro)

Amendamenti 6

Në tabelën 2 **Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2008, A: Organizatat buxhetore që janë IPVQ, Rishikimi Gjashtëmujor**, në kodin organizativ 205 'Ministria e Transportit dhe Post-Telekomit', :

- kod i programit 417 '**Ndërtimi i urave**' nga kategoria '**Shpenzimet kapitale**' hiqet shuma prej 284,900 €(dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind euro) nga shuma totale 7,549,804 € (shtatë milion, pesëqind e katërdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e katër euro)

- Kodi i programit 418 '**Rehabilitimi i rrugëve**' nga kategoria '**Shpenzime kapitale**' hiqet shuma prej 3,063,801 € (tre milion e gjashtëdhjetë e tremijë, tetëqind e një euro) nga shuma totale 69,370,361 € (gjashtëdhjetë e nëntë milion, treqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë një euro)

- Kodi i programit 421 '**Ndërtimet e reja te rrugëve**', nga kategoria '**Shpenzimet kapitale**' hiqet shuma prej 3,651,299 € (tre milion e gjashtë qind e pesëdhjetë e një mijë, dyqind e nëntëdhjetë e nëntë euro) nga shuma totale 27,546,579 € (njëzet e shtatë milion e pesëqind e katërdhjetë e gjatë mijë, pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë euro).

Amendamenti 7

Në tabelën 2 **Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2008, A: Organizatat buxhetore që janë IPVQ, Rishikimi Gjashtëmujor**, në kodin organizativ 206 'Ministria e Shëndetësisë', kod i programit 701 '**QKUK Prishtina**', nga kategoria '**Mallra dhe Shërbime**' hiqet shuma prej 1,000,000 €(një milion euro) nga shuma totale prej 5,774,415 €(pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë, e katërqind e pesëmbëdhjetë euro)

Amendamenti 8

Në tabelën 2 **Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2008, A: Organizatat buxhetore që janë IPVQ, Rishikimi Gjashtëmujor**, në kodin organizativ 209 'Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale', kod i programit 012 'Pensionet bazë – Kontributëdhënësit' nga kategoria 'Subvencione dhe Transfere', hiqet shuma prej 1,000,000 € (një milion euro) nga shuma totale prej 14,400,000 € (katërmbëdhjetë milion e katërqind mijë euro).

Amendamenti 9

Të gjitha mjetet financiare të tërhequra sipas amendamenteve, mbesin në Bilancin bankar të shfrytëzueshëm, i paraqitur në tabelën 1, pika 7 .

Bartjet e mjeteve financiare në kategorinë e 'Shpenzimeve kapitale', reflektohen në:

- Tabelën **1 Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës për 2008 R.B**
- Tabelën **2.D Përmbledhja e ndarjeve buxhetore 2008, Rishikimi gjashtëmujor**
- Tabelën **2.E Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës 2008, Përmbledhja e ndarjeve buxhetore për Organizatat buxhetore të Qeverisë Qendrore**
- Tabelën **4 Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës për vitin 2008, Buxheti kapital për Nivelin Qendror.**

Kryesuesi, njoftoi se ekzistojnë tri kërkesa nga tri Organizata Buxhetore përkitazi me rishikimin e buxhetit. Kërkoi nga përfaqësuesi i Këshillit Gjyqësor të arsyetoj kërkesën e tij.

Halit Muharremi drejtor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, arsyetoj kërkesën me nevojën për të bartur mjetet prej një pozicioni në tjetrin. Si rezultat i lëndëve të shumta, nevojiten mjete shtesë për shtesë për shërbimi postar, pastaj mirbajtja e sistemit të teknologjisë informative (deri më tani është financuar nga donatorët e jashtëm). Për shkak të problemeve me lejen e ndërtimit, për ndërtimin e ndërtesës së Këshillit kemi kërkuar që këto mjete të transferohen në pozicione tjera buxhetore, për të mbuluar shpenzimet shtesë që do ti kemi në pjesën e mbetur të vitit.

Zv.ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Bedri Hamza, theksoi se kërkesa në tërësi është përfshirë në buxhetin e rishikuar dhe transferet janë bërë ashtu siq është kërkuar. Bëri vërejtje për mos interesimin e parashtruesit të kërkesës për të ditur se çfarë është bërë me të.

Kryesuesi, njoftoi edhe për kërkesën e rëndësishme të Zyrës së Auditorit Gjeneral, të cilën komisioni e ka shqyrtuar dhe ka dhënë rekomandimet e tija se ekziston pengesë baza ligjore për të plotësuar kërkesat e tyre. Prandaj duke shfrytëzuar praninë e përfaqësuesve të ministrisë, kërkoi që të japin shpjegime nëse është e mundur të gjindet një zgjidhje e pranueshme ligjërisht, në të kundërtën kërkesa duhet shtyer për vitin tjetër. Përndryshe si Komision jemi shumë të interesuar të mbështesim këtë agjension në të gjitha format, edhe në formën financiare.

Niman Zeneli, arsyetoj kërkesën me nevojën për të stimuluar punëtorët për shkak se kjo ka ndikuar në ikjen e punëtorëve të trajnuar dhe të kualifikuar. Është nevoja urgjente për të mbështetur këtë Agjension duke ditur problemet që ballafaqohemi, në mënyrë që t'iu krijohen kushtet për punë normale.

Haki Shatri, njoftoi se rekomandimet e Komisionit lidhur me kërkesën e ZRGJ kanë qenë të qarta. I'u është rekomanduar se kërkesën ta drejtojnë në MEF, e nëpërmes saj të kalojë në Qeveri. Duke pasur

parasysh faktin se mungon baza ligjore për zgjidhjen e problemit, i rekomandohet MEF-it, nëse është e mundur të krijojë një bazë të tillë ligjore, që të mund të përkrahet kërkesa e këtij agjensioni.

Armend Zemaj, u pajtua me parafolësit se pengesë në realizimin e kërkesës ka qenë mungesa e bazës ligjore. Megjithatë, ka qenë shumë i interesuar të gjindet një zgjidhje e pranueshme. Duke shfrytëzuar praninë e përfaqësuesve të ministrisë, kërkoi ndihmën e tyre, nëse është e mundur të mbështet kërkesa e këtij agjensioni të rëndësishëm për vendin. Por gjithmonë duke pasur parasysh bazën ligjore.

Safete Hadërgjonaj, u pajtua me propozimet që duhet përkrahur kërkesa e këtij agjensioni, por që paraprakisht duhet krijuar baza ligjore për realizimin e kësaj kërkesë. Sipas z. Hadërgjonaj është e papranueshme që drejtori i Auditimit të Brendshëm të merr më shumë pagë se sa drejtori i Auditorit të Jashtëm. Andaj është nevojë e domosdoshme që të të zgjidhet ky problem, nëse jo tani vitin e ardhshëm gjithësesi.

Zv.ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Bedri Hamza, theksoi se kanë siguruar fondet në buxhet për kërkesën e kësaj zyre, por për shkak të mungesës së bazës juridike nuk janë alokuar. Kërkoi nga zyrtarët e Agjensionit të bëjnë projektin e detalizuar dhe të arsyetuar, duke kategorizuar nivelet e pagave dhe kërkesën t’ia përcjell MEF-it e përmes saj do t’i dërgohet Qeverisë, e cila me vendim, konform Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike, do të krijohet baza ligjore për të mbështetur një kërkesë të tillë.

Kryesuesi, kërkoi nga përfaqësuesit e ZAGJ, që të i’u përmbahen rekomandimeve të zv. Ministrisë dhe të parashtrorj kërkesën në MEF e nëpërmes saj në Qeveri konform Ligjit Menaxhimit të Financave Publike dhe në këtë mënyrë pasi që ekziston mundësia e krijimit të bazës ligjore, kërkesa të realizohet.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shtatë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Miratohet Kërkesa nr. 03/0869/Do-507 dt. 21.07.2008 e Zyrës së Auditorit Gjeneral të Kosovës për rishikimin gjashtëmujor të buxhetit 2008 për Zyrën e Auditorit Gjeneral të Kosovës dhe propozohet përfshirja e së njëjtës në tabelat buxhetore të Ligjit për ndryshimet e Ligjit nr. 03L-088 për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimeve të autorizuara për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008.
- II. I rekomandohet Zyrës së Auditorit Gjeneral të Kosovës që për implementimin e kërkesës së miratuar, të veprojë sipas nenit 7.8 të Ligjit nr. 03L-088 për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimeve të autorizuara për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008.

Kryesuesi, njoftoi anëtarët me kërkesën e parashtruar nga Kryesia e Kuvendit, me të cilën kërkohen punësimi nga një këshilltar, një asistent dhe një shofer për anëtarët e Kryesisë dhe për këta të punësuar kërkohen mjete shtesë. Kryesuesi u shpreh se është kundër aprovimit të kësaj kërkesë, për arsye se nuk është përfillur procedura e parashtrimit të saj në Komision, pastaj nuk mund të përkrahet një kërkesë e tillë, kur dihet se Kryesia ka refuzuar kërkesat e Komisionit për të punësuar një ekspert aq të nevojshëm për punën e Komisionit.

Haki Shatri, njoftoi se mjetet e kësaj kërkesë janë të parapara në buxhetin e rishikuar, andaj mundësia që mund të bëjë Komisioni është të propozoj amendament për ndryshuar atë.

Armend Zemaj, u shpreh kategorikisht kundër përkrahjes së kësaj kërkesë. Kjo për arsye se eksitojnë prioritete tjera që duhet përkrahur, siç është rasti i përmisimit të kushteve të deputetëve, sigurimi i zyrave dhe kushteve tjera për punë normale.

Safete Hadërgjonaj, po ashtu u shpreh kategorikisht kundër kërkesës. Më këtë rast bëri vërejtje për shkak të mospërfilljes së kompetencave të Komisionit, gjë që dëshmon se është shkelur edhe Rregullorja e Punës së Kuvendit. Lidhur më këtë kërkoi që të njoftohet Kryesia se disa herë ka neglizhuar Komisionin në çështjet që duhet paraprakisht të i shqyrtoj dhe të jep rekomandimet e tija.

Shkumbin Demaliaj, lidhur me kërkesën e Kryesisë së Kuvendit, theksoi anëtarët e Kryesisë janë pjesë e Komisioneve dhe aty marrin kompensimet si të gjithë deputetët tjerë. Duke ditur edhe faktin se deputetët tjerë janë të angazhuar në disa komisione dhe kompensohen vetëm për pjesëmarrjen në njërin, është e papranueshme kjo kërkesë dhe u deklarua se nuk do ta përkrah.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shtatë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Kërkesa buxhetore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (Kërkesa nr. 03/0837/Do-481 dt. 11.07.2008 për mjete plotësuese për stafin mbështetës politik në Kuvendin e Republikës së Kosovës), është shqyrtuar dhe e njëjta nuk është përkrahur nga Komisioni

5. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë çështje për tu diskutuar.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Gani KOCI